

jetonin në Gjakovë/Đakovica, në rrugën *Kolonia e Duhanit* pn. Nga fundi i muajit prill, Hajrullahun dhe djalin e tij Flamurin, i ka arrestuar policia serbe dhe i ka çuar në burgun e Prizrenit/Prizren. Flamurin e lëshuan pas disa ditësh, ndërkaq Hajrullahun vetëm në muajin qershor. Pas lirimit, Hajrullahu me Isufin shkuan në Studenčan/Studenčane për një vizitë te Flamuri, i cili prej lirimit nga burgu rrinte te halla e vet në këtë fshat. Pas vizitës, Hajrullahu dhe Isufi u nisën me linjën e rregullt të autobusit drejt **Suharekës/Suva Reka [24.06.1998]**. Jo shumë larg nga Suhareka/Suva Reka, autobusin e kanë ndaluar pjesëtarë të UÇK-së dhe i kanë nxjerrë jashtë Hajrullahun dhe Isufin. Nga ajo ditë, familjet nuk dinin asgjë për fatin e tyre. Pas gati tre muajsh, nga mesi i shtatorit, trupat e tyre të pajetë u gjetën në kanal in e **Liqenit të Radoniqit/Radonjičko jezero**, së bashku me trupat e afro 30 personave të tjerë. Hajrullahun e kanë varrosur në varrezat e Prizrenit/Prizren.

Burimet: deklarata E.G, FDH-36463; deklarata Sh.A, FDH-32539; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, IX, 439; ICTY, IT-04-84 (R. Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 03.04.2008, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-\(-IT-04-84-\);](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-(-IT-04-84-);) KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; MUP RS, Krivična prijava, 28.09.1998, FDH-33036.

Isa (Halil) Shehu

(12.09.1955, shqiptar nga Vraniqi/Vranić, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor ndërtime, katër fëmijë)

Në orët e vona të mbrëmjes, më **28.06.1998**, në shtëpinë familjare të Isës në **Vraniq/Vranić** kanë ardhur disa pjesëtarë të armatosur të UÇK-së. E kërkuan armën e Isës, por ai u tha se e kishte dorëzuar dhe, si dëshmi, u tregoi vërtetimin për dorëzimin e saj. Atëherë, ushtarët i urdhëruan që të nisej me ta me makinën e vet të tipit *Mercedes*. Ishte kjo hera e fundit që familjarët e Isës e shihnin atë të gjallë. Trupi i tij i pajetë u zbulua një ditë më vonë në fshatin Mamushë/Mamuša [Prizren],

pranë depos në pronë të ndërmarrjes *Nasi-Impeks*. E kishin ekzekutuar me një plumb në ballë. Pas obduksionit në morgun e Prizrenit/Prizren, më 30.06.1998, trupi i tij iu dorëzua familjes, e cila e ka varrosur po atë ditë në varrezat e Vraniqit/Vranić.

Burimet: deklarata M.S, FDH-35020; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; Gjykata e Qarkut Prokuplje K.nr. 95/99 (Loshi Gzhim dhe të tjerë), aktgjykimi, 9.11.1999, FDH-2064; AIS, *Zona...*, 46 i 57, FDH-16913; SMIP, *Teroristički...*, III, 72.

Liman (Selim) Gashi

(2.05.1955, shqiptar nga Gjinoci/Đinovce, komuna e Suharekës/Suva Reka, arkëtar, tre fëmijë)

Limani punonte në ndërmarrjen *Metohijavino* në **Shirokë/Široko**. Në mëngjesin e datës **1.07.1998**, si zakonisht, ai shkoi në punë me veturën e vet të tipit *Opel Ascona*. Pas punës, u nis për në Reshtan/Raštane për të blerë një pjesë për lavatriqe. Me vete i kishte 2.000 marka gjermane dhe pistoletën zyrtare. E kanë vrrarë në rrethana të pasqaruara. Më 10.07.1998, policia serbe e ka njoftuar familjen se trupi i Limanit ishte gjetur pranë rrugës, në mes të Leshanit/Lešane dhe Tërnrjes/Trnje. Në trup i kishte disa plagë nga armë zjarri, dëmtime dhe hematome nga keqtrajtimi fizik. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur në varrezat e fshatit Gjinoc/Đinovce.

Burimet: deklarata I.G, FDH-32533; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, IX, 439; SMIP, *Teroristički...*, III, 242, 914; AIS, *Zona...*, 46, 58, FDH-16913; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Kadri (Sadri) Kokollari

(19.08.1964, shqiptar nga Budakova/Budakovo, komuna e Suharekës/Suva Reka, bujk, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Gjatë viteve të nëntëdhjeta, Kadriun e kanë marrë disa herë në polici për shkak të aktiviteteve të tij politike. U inkuadrua në UÇK në fillim të vitit 1998. Ka qenë vëzhgues dhe diversant. Ka rënë më **3.07.1998**, gjatë përlëshjeve të armatosura me forcat